



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 27 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Munguan: Enis Kervan, Shaip Muja dhe Sabri Hamiti.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu - EUSR, Lumnije Murati - ZPRK; Florije Mehmeti - KDI Besarta Zuka –NDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga takimet e mbajtura më 25 e 27 prill dhe 18 e 29 maj 2012;
3. Letër komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës;
4. Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për tremujorin e dytë të vitit 2012;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga takimet e mbajtura më 25 e 27 prill dhe 18 e 29 maj 2012;

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga takimet e mbajtura më 25 e 27 prill dhe 18 e 29 maj 2012.

3. Letër komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës

Albin Kurti - Tha se kjo pikë e rendit të ditës është e paraparë në Planin tonë të punës, dhe është radhitur për diskutim nga fakti se pesë vende të BE-së, Spanja, Greqia, Qipro, Rumania dhe Sllovakia ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Propozoi që kjo çështje të diskutohet dhe nëse akordohen deputetët, të gjithë kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme të këtyre vendeve t'u dërgohet një letër e argumentuar, ku do t'ju sugjerohej, këshillohej dhe do të inkurajoheshin kryetarët e këtyre komisioneve që ta mbështesin pavarësinë e Republikës së Kosovës. Ai tha se disa nga këto shtete janë keq të informuara për Kosovën nga Serbia dhe miqtë e saj, e disa po ashtu kanë edhe probleme të tyre të brendshme. Propozoi që pas diskutimeve në Komision, të angazhohet ndonjëri nga anëtarët për përpilimin e kësaj letre.

Donika Kadaj -Bujupi - Theksoi se në mungesë të raporteve ndër qeveritare, angazhimi Komisionit dhe Kuvendit përmes këmbimit të letrave dhe vizitave mundëson dhënien e argumenteve të fuqishme për vendin tonë, në kundërshtim me opinionet e njëanshme që ekzistojnë kryesisht të pesë vendet BE-së, për njohjen e Kosovës. Propozoi që Komisioni t'i drejtohet komisioneve homologe të shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, me pesë letra të ndryshme, në të cilat varësisht nga specifikat e tyre do të ngërtheheshin argumentet ose kundër argumentet, në raport me njohjen e Kosovës.

Skender Hyseni - Lidhur me propozimin për letër komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, tha se nëse do t'ju shkruhet, duhet të shkruhet vetëm një letër. Kjo letër tha se duhet të ketë për synim influencimin e deputetëve të vendeve përkatëse, që të anojnë nga njohja e Kosovës. Këto shtete të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme për Kosovën, por për shkak të qëndrimeve të tyre politike nuk e kanë njohur, pavarësinë e Kosovës. Kosova si shtet duhet të vazhdojë të bëjë presion në BE, në qendrat e mëdha dhe në secilin shtet veç e veç, që vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, ta njohin atë.

Amir Ahmeti - E përkrahu mendimin e deputetit S. Hyseni, se vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, nuk është se nuk kanë njohuri të mjaftueshme për Kosovën. Duke pasur parasysh zhvillimet të cilat kanë ndodhur në shumë vende të botës, vlerëson se është mirë që të bëhet përsëritja e letrave dhe kërkesave për njohje të Kosovës. Propozon që letra e Komisionit të mos jetë e kufizuar vetëm në pesë shtetet e BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por t'i adresohet të gjitha vendeve të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ky do të ishte një hap i mirë dhe i nevojshëm, i cili mund të jepte rezultat në zbutjen e qëndrimeve tek ato vende.

Donika Kadaj -Bujupi - Tha se është e vërtetë se pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën kanë informacione për Kosovën, por informacionet e tyre janë të njëanshme dhe të plasuar nga Serbia. Insistoi në adresimin e pesë letrave duke i specifikuar për pesë vendet e BE-së, me arsyetimin se do të kenë efekte më të mëdha.

Hydajet Hyseni - Adresimin e letrës pesë vendeve të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, e konsideron ide të mirë, të paraparë edhe me Planin e punës së Komisionit dhe një linjë e funksionimit të Komisionit që duhet të jetë e vazhdueshme, në proces. Përkrahë propozimin për të dërguar një letër, por nëse për ndonjë vend të caktuar ka arsye që të theksohet ndonjë specifikë, tha se ajo mund të bëhet. Për këtë çështje vlerëson se është mirë që Komisioni të harmonizohet me MPJ-në, dhe të kërkojë nga MPJ-ja ndihmën dhe informacionet që i kanë për secilin prej këtyre shteteve të cilave mendojmë t'i adresohemi. Propozoi që kryetari i Komisionit në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit, duke përfshirë edhe angazhimin e partnerëve ndërkombëtarë, të përgatisë një draft-letër e cila më pas do të diskutohej në mbledhje të Komisionit.

Albin Kurti - Si çështje të nevojshme të cilat do të mund të ceken në këtë letër përmendi: çështjen e të drejtave dhe privilegjeve të komuniteteve, mos ekzistimin e ndarjes që e sajton Serbia në stilin shqiptarët dhe të tjerët; elementin e shpërbërjes së Jugosllavisë; kundërthëniet e brendshme në ish – Jugosllavi dhe faktin që përbrenda saj ka pasur shumë diskriminim; **sfidimin** e një lloj cinizmi që qëndron në disa qarqe diplomatike për Ballkanin; qëndrimin paqësor të popullit tonë; paralajmërimin e vizitave në këto vende dhe ftesa për vizita të tyre te ne.

Si efekt pozitiv të kësaj letrë, theksoi pajisjen e komisioneve homologe me argumente të kundërta nga qeveritë e shteteve të tyre.

Skender Hyseni - Theksoi se këto pesë vende të BE-së, nuk kanë të bëjnë me mungesë të informatave për Kosovën, por për përqafim të qëllimshëm të variantit serb. Përkrah dërgimin e vetëm një letrë me kërkesë për vënien e kontakteve, e nëse arrihet të vihen kontaktet tha se atëherë mund të bëhen shpjegimet veç e veç për secilin vend. Propozoi për formën e letrës, përmbajtjen e saj dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar në hartimin e letrës.

Anëtarët e Komisionit, Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skender Hyseni e Amir Ahmeti diskutuan për formën, elementet dhe argumentet të cilat do t'i ishte mirë t'i përmbante letra drejtuar pesë vendeve të BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën.

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Angazhohen kryetari dhe deputeti Skender Hyseni, që ta hartojnë draft- letrën për komisionet homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës.

4. Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për tremujorin e dytë të vitit 2012

Albin Kurti - Tha se mbështetur në Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për tremujorin e dytë të vitit 2012, kapitullit 2.3, Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare, veprime për Komisionin për Punë të Jashtme janë propozuar: *“Raport nga Ministria e Punëve të Jashtme lidhur me mungesën e një marrëveshjeje formale mes Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë e cila është pengesë ndaj qartësisë të pohimeve në lidhje me mbetjet mortore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”* si dhe *“Raport nga Ministria për Punë të Jashtme lidhur me gjetjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme për pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale.”*

Përbushjen e veprimeve të propozuara sipas pikave P74 dhe P77, të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për tremujorin e dytë, tha se Komisioni e ka shqyrtuar në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2012 dhe ka vendosur që të kërkojë Raport me shkrim nga MPJ. MPJ-a nuk i është përgjigjur kërkesës së Komisionit, lidhur me raportet me shkrim të kërkuara për sfidat e parapara.

Komisioni për Integritet Evropian ka kërkuar nga komisionet parlamentare, që të raportojnë për përbushjen e obligimeve sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për tremujorin e dytë të këtij viti, deri më 30 qershor.

Hydajet Hyseni - Theksoi se çështja e integriteteve evropiane është prioritetet edhe për Komisionin për Punë të Jashtme. Po ashtu edhe çështja e marrëdhënieve ndërkombëtare, ka mbetur e pa sistemuar dhe në gjithë procesin e marrëveshjeve ndërkombëtare Komisioni është jashtë procedurës, gjë të cilën e konsideroi të padrejtë. Propozoi që Komisioni nga këndvështrimi i tij, në njërin nga mbledhjet e ardhshme, të shqyrtojë Raportin e Progresit në tërësi, si dhe përbushjen e detyrave nga Komisioni për Integritet Evropian, nga komisionet parlamentare dhe nga institucionet e tjera sipas Planit të Veprimit të Kuvendit.

Pas këtij njoftimi, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të njoftohet Komisioni për Integritet Evropian, se për përbushjen e veprimeve të propozuara sipas pikave P74 dhe P77, të Planit të Veprimit të Kuvendit të për Integritet Evropian, Komisionit nuk i janë sjellë raportet me shkrim nga MPJ-a.

5. Të ndryshme

1. Albin Kurti i njoftoi se grupi punues i Komisionit gjendet në fazën e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, dhe se ka shprehur nevojën që të jetë i mbështetur në punën e tij prej ndonjë Instituti ose eksperti, nga mjetet e buxhetit të Komisionit.

Njëkohësisht njoftoi se Grupi punues sot do ta ketë një takim në MPJ, ku do të takohet me sekretarin dhe drejtorin e MPJ-së, me ç' rast do të diskutohet lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Anëtarët e Komisionit u njoftuan lidhur me takimin të cilin e ka pasur Grupi punues me përfaqësues të NDI- së, në të cilin takim është kërkuar që Komisioni të ketë mbështetje nga një ekspert i përhershëm, nga sfera e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politika e jashtme.

Pas diskutimeve lidhur me angazhimin e ekspertit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Angazhohet eksperti Dren Doli, nga Instituti “Grupi për studime juridike dhe politike”, që ta mbështesë punën e Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

2. Donika Kadaj- Bujupi - Tha se i ka parashtruar një propozim, anëtarëve të Komisionit lidhur me diplomacinë parlamentare. Lidhur me këtë propozim për diplomacinë parlamentare tha se, nëse Komisioni do ta përkrahë është e gatshme që të hartojë një plan, me dinamikat dhe specifikat për realizimin e tij, si dhe të angazhohet nëse është e nevojshme për gjetjen e resurseve për zbatimin e planit.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Përkrahet propozimi i deputetes Donika Kadaj- Bujupi, për hartimin e Propozim-planit lidhur me diplomacinë parlamentare.

3. Mbështetur në propozimin e deputetit Hydajet Hyseni, për nevojën e organizimit të tryezave nga Komisioni, u vendos që Komisioni në mbledhjen e radhës, më 29 qershor, ta propozojë në rend dite: Diskutimin lidhur me organizimin e një tryeze për politikën e jashtme të Kosovës.

Takimi përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti